



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 582/2 Prot.

Tiranë, më 19.02.2025

VENDIM

Nr. 10 Datë 19.02 2025

**“PËR
MIRATIMIN E BURSAVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIMIN NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT TË CIKLIT TË PARË QË PLOTËSOJNË KRITERET,
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, në Vendimin Nr. 32 datë 07.08.2024 "Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs, regjistrimit të fituesve, për ciklin e parë dhe të dytë, të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të 3 ciklet e studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin Nr. 41 datë 31.10.2024 "Për Miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa shkollimit për ciklin e parë të studimeve, reduktim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Relacionin e Komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit me nr. 364 prot, datë 28.01.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e studimit për ciklin e parë të studimeve", në Relacionin e Administratorit nr.486 prot, dt 07.02.2025

Bordi i Administrimit ,

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 1, tabela bashkëngjitur;

2. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 4, tabela bashkëngjitur
3. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 14, tabela bashkëngjitur;
4. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2024-2025, dhe studentët që kanë aplikuar pas afatit 15.12.2024 llogariten sipas datës së aplikimit.
5. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MAS dhe AKFAL.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, Fakulteti i Shkencave të Levizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit , Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI



Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar I perjashtimit	Efekti Financiar I Burses
1	EF813A110451	A. Xh	3486/10	20.11.2024	FSHR	3	17,500	90,000
2	EF813A120190	O. H	3486/26	02.12.2024	FSHL	2	17,500	90,000
3	EF813A120236	K. Q	3706/11	05.11.2024	FSHL	2	17,500	90,000
4		A. D	3781/20	12.12.2024	FVFR	1	17,500	90,000
5	EF813A110302	D. L1	3781/2	12.12.2024	FSHL	3	17,500	90,000
6	EF813A110019	O. A	3781/17	11.12.2024	FVFR	3	35,000	90,000
7	EF813A110332	S. Q	3781/9	11.12.2024	FSHR	3	17,500	90,000
8	EF813a120237	A. L1	3813/12	20.12.2024	FSHL	2	35,000	63,636
9	EF813A110099	G. Sh	3813/17	20.12.2024	FVFR	3	17,500	63,636
10	EF813A120219	O. Ç	3813/15	20.12.2024	FSHL	2	35,000	63,636
11		E. D	3300	12.11.2024	FSHL	1	17,500	90,000
Totali							245,000	910,909

Kriteri 4 Studentët që i kanë të 2 prindërit me aftësi të kufizuara

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar I perjashtimit	Efekti Financiar I Burses
1		B. H	148/1	14.01.2025	FSHR	1	17,500	55,455

Kriteri nr. 14: Studentët të cilët kanë të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me KMCAP, përfitues i pagesës së aftësisë të kufizuar

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar I perjashtimit
1	EF813A110214	M. B	3813/16	20.12.2024	FVFR	3	17,500
2	EF813A120192	Xh. K	148	14.01.2024	FSHL	2	17,500
3	EF813A110319	A. M	166/1	16.01.2025	FSHL	3	17,500
4		K. M	166	16.01.2025	FVFR	1	35,000
Totali							87,500

Eduard Meçaj